



Pranuar / Dorezuar Prijmjeno / Predato Received / Delivery	24.12	2020	0	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
S-KPH/SHOR 3289/2020			1/3	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.378/2020

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.349/2020 të datës 06.11.2020 të parashtruar nga ankuesja [REDACTED], e përfaqësuar nga Avokat Ahmet Kasumi me adresë Rr. “Fehmi Agani” 46/2 Prishtinë, si dhe ankesën me numër A.nr.378/2020 të datës 30.11.2020 të parashtruar nga ankuesja Besnike Ukmata e përfaqësuar nga Avokat Arianit Koci dhe Granit Vokshi me adresë rruga “Robert Doll”, Nr. 19 në Prishtinë, të bashkuara në një ankesë të vetme me numër A.nr.378/2020, kundër organit të punësimit Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike “largim nga shërbimi civil” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.12.2020, mori këtë;

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.378/2020 e datës 30.11.2020, e parashtruar nga ankuesja, [REDACTED].
- II. ANULOHET Vendimi me numër V.Nr.KD/02/2020 i datës 02.11.2020 i Komisionit Disiplinor të Aviacionit Civil të Kosovës për pezullim nga marrëdhënia e punës së ankueses [REDACTED].
- III. SHFUQIZOHET Vendimi me numër V.Nr.KD/05/2020 i datës 26.11.2020 i Komisionit Disiplinor të Aviacionit Civil të Kosovës për Largim nga Shërbimi Civil të ankueses [REDACTED].
- IV. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesen [REDACTED] në Drejtoreshë e Departamentit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës sipas Akt Emërimit të datës 10.01.20012, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e saj e punës duke bërë

kompensimin e pagës së ankueses nga data e pezullimit të marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

██████████, Drejtoreshë e Departamentit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, me datë 02.11.2020 është pezulluar nga marrëdhënia e punës me Vendimin V.Nr.KD/02/2020 të datës 02.11.2020 të Komisionit Disiplinor.

Kundër Vendimit V.Nr.KD/02/2020 të datës 02.11.2020 të Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, ankuesja me datë 06.11.2020 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 2503/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.11.2020 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës. Këshilli më datë 25.11.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë, bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Aviacionit Civil më datë 26.11.2020 ka nxjerr vendim me numër V.Nr.KD.05.2020 me të cilin ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil".

Ankuesja kundër Vendimit V.Nr.KD.05.2020 të datës 26.11.2020 të Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, me datë 30.11.2020 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 2830/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.12.2020 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës. Këshilli më datë 21.12.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë, bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2503/2020 të datës 06.11.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-mailin e datës 22.10.2020 nga ██████████ për ankuesen; E-mailin e datës 09.10.2020 nga ██████████ për ankuesen; E-mailin e datës 09.10.2020 nga ██████████ për Safete Selmani për inicim të procedurës disiplinore; Vendimin me Nr. Ref:49/2020 të datës 04.09.2020 për caktimin e anëtarëve të Komisionit Disiplinor; E-mailin e datës 23.10.2020 nga ankuesja për ██████████; E-mailin e datës 29.10.2020 për ankuesen; E-mailin e datës 29.10.2020 nga ██████████ për ██████████; E-mailin e datës 28.10.2020 nga ██████████ për ██████████; E-mailin e datës 28.10.2020 nga ██████████ për ██████████; Vendimin V.Nr.KD/02/2020 i datës 02.11.2020 i Komisionit Disiplinor i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës; Vendimin Ref:07/2018 i datës 18.09.2018 i Komisionit Disiplinor i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës; Kallëzimin Penal ndaj zyrtarëve publik i datës 31.12.2019; Shkresa e datës 15.11.2019 nga Drejtori i Përgjithshëm; Njoftimi i datës 27.12.2019 nga Agjencia Kundër Korrupsionit; Shpresa për Informim i keqpërdorimit të buxhetit të shtetit dhe të mashtrimit nga zyrtarët e latë të AAC-së i datës

15.11.2019 nga [REDACTED], Autorizimin e datës 03.11.2020 dhe 06.11.2020; Njoftim nga ankuesja i datës 23.11.2020; E-mailin e datës 24.09.2020 nga ankuesja për [REDACTED]; E-mailin e datës 23.09.2020, 28.09.2020 dhe 29.09.2020 nga [REDACTED] për ankuesen; E-mailin e datës 30.09.2020 nga ankuesja për [REDACTED] Shkresën për Rregullimin Ekonomik me LKIA nga Drejtori i Përgjithshëm AAC e datës 17.07.2020; Shkresën për Rregullimin Ekonomik nga Drejtori i Përgjithshëm AAC e datës 27.07.2020; Shkresë nga Zyra e Prokurimit nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës datë 30.08.2019 dhe 20.12.2019; Vendimi e datës 30.09.2019 nga Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së; E-mailin e datës 23.07.2020 nga [REDACTED]; E-mailin e datës 23.07.2020 nga [REDACTED] G. [REDACTED] E-mailin e datës 23.07.2020 nga Nora Bakalli; E-mailin e datës 22.10.2020 nga [REDACTED] për ankuesen; Procesverbal i datës 20.10.2020; E-mailin e datës 23.10.2020, 22.10.2020 nga [REDACTED] për ankuesen; Procesverbalin e datës 20.10.2020, 29/30.10.2020, 02.11.2020 të Komisionit Disiplinor; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik të Aviacionit i datës 13.06.2017; Deklaratë e datës 28.10.2020 nga [REDACTED] Vendimi A.690/2018 i datës 10.12.2018 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 29.10.2020, 30.10.2020 nga [REDACTED] për [REDACTED] dhe [REDACTED]; E-maili i datës 30.10.2020 nga [REDACTED]; E-maili i datës 30.10.2020 nga [REDACTED] për [REDACTED]; Ftese për intervistë në cilësi të dëshmitares e datës 03.11.2020 nga [REDACTED] për [REDACTED]; Ftese për intervistë në cilësi të dëshmitares e datës 03.11.2020 nga [REDACTED] për [REDACTED] Vendim i datës 05.11.2020 për shtyrje të afati për marrjen e vendimit të Komisionit Disiplinor; Rregullore Nr.4/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në Tokë e datës 30.05.2011; Shtojë për Listën e Shërbimeve në Tokë; Kriteret dhe procedurat për aprovimin e Shërbimeve në Tokë; Formulari për Aprovim si Furnizues për Shërbime në Tokë apo si Vetëshërbyes; Shkresë për Përgjegjësin për implementimin e Rregullores nga ankuesja datë 21.11.2020; Referencën e datës 12.03.2019; E-mailin e datës 14.05.2019 nga ankuesja për [REDACTED] E-mailin e datës 26.04.2019 nga [REDACTED] për ankuesen; Procesverbal i takimit AAC rreth çështjes së furnizuesit me karburant në ANP datë 20.07.2020; Aprovimi i furnizuesve të shërbimeve në tokë në ANP "Adem Jashari" datë 01.07.2020; E-mailin e datës 21.07.2020 nga ankuesja; E-mailin e datës 20.07.2020 nga [REDACTED]; E-mailin e datës 06.07.2020 nga [REDACTED] Njoftim për ngjarjet politike 1-30 gusht 2019; E-mailin e datës 22.07.2020 nga ankuesja për [REDACTED] dhe anasjelltas; E-mailin e datës 13.08.2020 nga Arianit Dobroshi për [REDACTED]; E-mailin e datës 17.12.2020 nga ankuesja për [REDACTED] E-mailin e datës 09.12.2019 nga [REDACTED] për ankuesen; E-mailin e datës 13.10.2020 nga [REDACTED] për ankuesen; E-mailin e datës 03.08.2020, 27.07.2020 nga [REDACTED] për ankuesen; E-mailin e datës 27.07.2020, 21.07.2020 nga ankuesja për Omer Kuyucu; Shkresën e datës 26.03.2019 nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës; Sqarimin ndaj shkesës ne. 2019/ZDP/51 të datës 12.03.2012 lidhur me tregun e ofruesve për shërbimet në tokë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës datë 02.05.2019; Shkresën e datës 13.05.2019 për Ilir Rama nga Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së; Shkresën nga Zyra e Prokurimit e datës 30.08.2019, 20.12.2019 nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës; E-mailin e datës 03.07.2020 nga BRAIN Simon për ankuesen; Ankesën me numër të protokollit 2830/2020 të datës 30.11.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 30.11.2020; Vendimi V.Nr.KD/05/2020 i datës 26.11.2020 i Komisionit Disiplinor; Vendimi me Nr. Ref:38/2019 i datës 06.09.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesen datë 20.12.2018 dhe 30.01.2020; Vendimin me Nr. 1/2020 i datës 14.12.2020 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për bashkimin e ankesave të ankueses; Vërejte për dosjen personale nga Drejtori i përgjithshëm i ACC e datës 28.02.2020; Vërejtjen e datës 08.10.2020; Akt Emërimit e ankueses i datës 10.01.2012; Rregullore (AAC) Nr. 05/2019 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 04/2011 për Qasje në Tregun e Shërbimeve në Tokë;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës, ka konstatuar së Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, me datë 09.10.2020 përmes e-mailit zyrtar ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankueses për shkelje të rënda disiplinore, gjegjësisht *për mos përmbushje të detyrave të punës, mos respektim të afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave të punës dhe mos zbatim të dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale.*

Komisioni Disiplinor i themeluar nga Drejtori i Përgjithshëm, me Vendim Nr.Ref.49/2020 të datës 04.09.2020, në përbërje nga: [REDAKTUAR] kryesues; dhe [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] anëtarë, përmes e-mailit zyrtar të datës 22.10.2020 e kanë ftuar ankuesen në seancë dëgjimore me datë 26.10.2020.

Ankuesja, me datë 23.10.2020, përmes e-mailit zyrtar ka kërkuar nga Kryesuesi i Komisionit Disiplinor, që t'i ofrohen provat lidhur me shkeljet e supozuara, si dhe e ka njoftuar lidhur me ekzistimin e konfliktit të interesit me anëtarin e komisionit, [REDAKTUAR] për shkak se në cilësinë e Kryetares së Komisionit Disiplinor, me datë 18.09.2018 përmes Vendimit KD/07/2018, [REDAKTUAR] i ka shqiptuar masën disiplinore "Pezullim nga marrëdhënia e punës për 2 (dy) muaj dhe ndalja e 1/3 e rrogës", andaj, ka kërkuar largimin e saj nga Komisioni Disiplinor.

Kryetari i Komisionit Disiplinor, me datë 28.10.2020, përmes e-mailit zyrtar, kërkesën e ankueses për ekzistimin e konfliktit të interesit me anëtarin e komisionit [REDAKTUAR], e ka adresuar tek Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës. Ky i fundit, përmes e-mailit zyrtar të datës 28.10.2020, ka njoftuar Kryetarin e Komisionit Disiplinor se nuk ka konflikt interesi në rastin konkret, dhe nuk ka nevojë të ndryshohet përbërja e Komisionit Disiplinor, duke kërkuar që të vazhdojë punën, komisioni. Bazuar në këtë, Kryetari i Komisionit Disiplinor, me datë 29.10.2020, përmes e-mailit zyrtar, ka njoftuar ankuesen se çështja e ngritur nuk konsiderohet konflikt interesi, dhe e ka ftuar në seancë dëgjimore me datë 30.10.2020, në ora 13:30.

Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, me datë 02.11.2020, ka nxjerr Vendim me numër V.Nr. KD/02/2020 përmes të cilit nëpunësen civile [REDAKTUAR], e ka pezulluar nga marrëdhënia e punës deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Komisioni Disiplinor.

Parashtruesja e ankesës pretendon se Vendimi me numër V.Nr. KD/02/2020 i datë 02.11.2020 i Komisionit Disiplinor i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, është nxjerr përmes shkeljes së dispozitave të procedurës administrative, për shkak se nuk është marr parasysht kërkesa e saj për ekzistimin e konfliktit të interesit me anëtarin e Komisionit Disiplinor.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses, fillimisht ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe ka konstatuar se me dispozitat e nenit 49 paragrafi 1 është përcaktuar se në çdo institucion, themelohet një komision disiplinor me mandat 3 vjeçar, që përfshin së paku një përfaqësues të njësisë përgjegjëse, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar së Qeveria, me propozimin e ministrit së përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për themelimin, përbërjen, përzgjedhjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor, në përputhje me rregullat e përgjithshme të përcaktuara në Ligjin për Procedurat e

Përgjithshme Administrative. Si rrjedhojë, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 21.08.2020 ka aprovuar Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se me dispozitat e nenit 10 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, është rregulluar themelimi dhe përbërja e Komisionit Disiplinor, ku përcaktohet se: *2. Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist dhe ka këtë përbërje: 2.1 Nëpunës civil i nivelit drejtues – Kryesues i Komisionit; 2.2. Nëpunës civil i nivelit profesional – anëtar dhe 2.3. Nëpunës civil i njësisë së burimeve njerëzore – anëtar.* Në këtë kuptim, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës me Vendimin Nr.Ref.49/2020 të datës 04.09.2020, ka themeluar Komisionin Disiplinor në përbërje nga: [REDAKTUAR], kryesues; dhe [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] anëtarë, mirëpo nuk ka specifikuar në vendim, titullin e pozitës dhe kualifikimin e anëtarëve të Komisionit Disiplinor, siç kërkohet me dispozitat ligjore përkatëse, andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se në vendimin mbi themelimin e Komisionit Disiplinor duhet të përshkruhet edhe pozita e punës dhe kualifikimi i anëtarëve, në mënyrë që të konstatohet së në përbërje të komisionit janë tre (3) anëtar me status të nëpunësit civil, ku njëri prej tyre duhet të jetë nëpunës civil i nivelit drejtues dhe një nëpunës civil me kualifikim në fushën e drejtësisë.

Lidhur me pretendimin ankimor për ekzistimin e konfliktit të interesit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson së Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat procedurale, për arsye se me Vendimin Nr.Ref.49/2020 të datës 04.09.2020, si anëtare të Komisionit Disiplinor ka caktuar Safete Selmani, e cila ka marr pjesë në shqyrtimin e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses, kështu që në viti 2018 me konkretisht në bazë të Vendimit me numër Ref:07/2018 të datës 18.09.2018 të Komisionit Disiplinor, ku ankuesja ka qenë në cilësinë e kryesuese së këtij komisioni në bazë të cilit [REDAKTUAR] i është shqiptuar masa disiplinore "pezullohet nga marrëdhënia e punës për dy muaj dhe gjatë periudhës së pezullimit i ndalohej 1/3 e rrogës". Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke e vlerësuar këtë rrethanë, konstaton se meqenëse ankuesja ka qenë në këtë cilësi, atëherë [REDAKTUAR] ka qenë e dëmtuar nga ky vendim, mbi këtë bazë kjo paraqet direkt konflikt interesi, rrjedhimisht është obligim ligjor që nëse *Kryesuesi apo anëtarët e komisionit disiplinor kanë konflikt interesi apo kur konflikti interesit paraqitet ndërkohë duhet të zëvendësohen siç përcaktohet me nenin 10 paragrafin 5 nën paragrafin 5.2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, përcaktohet se: "Në rast kur Kryesuesi apo anëtarët e komisionit disiplinor kanë konflikt interesi apo kur konflikti interesit paraqitet ndërkohë ata zëvendësohen nga Udhëheqësi më i Lartë Administrativ i Institucionit për raste si në vijim: Kur kryesuesi apo anëtari i komisionit ka qenë i dëmtuar nga shkelësi i dyshuar",* kështu që Autoritetit i Aviacionit Civil të Kosovës ka qenë i obliguar të ndërmarr këtë veprim bazuar edhe në nenin 29 paragrafin 1 nën paragrafin 1.10 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se konflikti i interesit në këtë çështje mund të konstatohet edhe në bazë të asaj që znj. Selmani më datë 15.11.2019 për Drejtorin e Përgjithshme ka përgatitur shkresë informuese për keqpërdorime të buxhetit të shtetit dhe të mashtrimit nga zyrtarët e lartë të AAC-së në mesin e tyre edhe ankuesja ku në bazë të kësaj shkrese është paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Edhe pse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin A.nr.690/2018 të datës 10.12.2018 ka shfuqizuar Vendimin me numër Ref:07/2018 të datës 18.09.2018 të Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me të cilin është hequr masa disiplinore ndaj znj. Safete Selmani, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se kjo nuk nënkupton që znj. Selmani nuk ka qenë e dëmtuar nga ankuesja. Meqenëse Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës në bazë të e-mailit të datës 28.10.2020

ka konstatuar se në këtë çështje nuk ka konflikt interesi, mbi këtë bazë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës nuk është personi kompetent për të vlerësuar që ka apo jo konflikt të interesit sepse Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës në bazë të Vendimit me N. Ref:38/2019 të datës 06.09.2019 ka të caktuar Zyrtarin Përgjegjës për rastet e konfliktit të interesit.

Këshilli Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.11.2020 ka pranuar ankesën me numër protokollit 2830/2020 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit V.Nr.KD/05/2020 të datës 26.11.2020 të Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës. Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 14.12.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 1/2020 me të cilin ka bërë bashkimin e ankesës me numër A.nr.349/2020 të datës 06.11.2020 dhe ankesës me numër A.nr.378/2020 të datës 30.11.2020 të ankueses ██████████ ██████████ me arsyetimin shqyrtimin e ankesave bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses kundër Largimit nga Shërbimi Civil respektivisht kundër Vendimit V.Nr.KD/05/2020 të datës 26.11.2020 të Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, që kanë të bëjnë me atë se: Largimi nga shërbimi civil nga Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi sepse nuk janë vërtetuar saktë provat e lëndës.

Inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankueses është bërë me arsyetimin se Implementimi i rregullores 04/2011 dhe hapja e tregut për ofruesit e shërbimeve në tokë është një nga sfidat kryesore të AACK. Qasja znj Besnike Ukmata si përgjegjës për këtë rregullore është e pa pranueshme, kjo tregohet përmes korrespondencës përmes email-ve si dhe takimet e përbashkëta në vend që të merr përgjegjësi, të ofron përkrahje dhe zgjidhje për implementimin e rregullores, ajo haptazi refuzoi të përfshiheni në përpjekje për implementim të rregullore duke bartua përgjegjësi tek të tjerët dhe jap arsyetim tjera që pengojë implementimin e rregullores. Sjellja e tillë paraqet shkelje të rënd disiplinore dhe sipas Ligjit Nr. 06/L-114, neni 46. 3.1. Mospërbushja e detyrave të punës, 3.2 mosrespektimi i afateve të caktuara në përbushjen e detyrave, të cilat kanë sjell pasojat të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale.

Lidhur me këtë rast Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Aviacionit Civil më datë 26.11.2020 ka nxjerr Vendim me numër V.Nr.KD/05/2020 me të cilin ankueses i ka shqyrtuar masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil", mirëpo sipas Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, përveç konstatimeve të lartcekura, konstaton se Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër V.Nr.KD/05/2020 nuk ka marr fare parasysh faktet vendimtare respektivisht vlerësimin e rezultateve në punë të ankueses e cila në bazë të Formularit për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 20.12.2018 dhe datës 30.01.2020, ka përbushur detyrat e punës duke u vlerësuar me notë të përgjithshme 4.7 respektivisht dhe 4, rrjedhimisht ky fakt është shumë me rëndësi sepse nëse ankuesja nuk do të kishte përbushur detyrat e punës atëherë edhe vlerësimi do të ishte ndryshe (mos të themi negativ). Po ashtu komisioni disiplinor ka vlerësuar gabimisht provat apo nuk ka vlerësuar drejt të njëjtat sepse zbatimi i Rregullores Nr. 04/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në Tokë nuk është e tëra përgjegjësi e ankueses sepse në përshkrimin e detyrave të punës së Departamentit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës konstatohet se cilat janë përgjegjësit e këtij departamenti me raport me Rregulloren Nr. 04/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në Tokë, po ashtu në komunikimet sipas shkresës sqaruese të datës 02.05.2019 nga Divizioni për Monitorimin e Kontratave, Departamenti Qendror për PPP me Drejtorin e

Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, konstatohet se: **“Prandaj neni 69 i Ligjit nr. 03/L051 lidhur me nenin 7 të Rregullores nr.04/2011 mund të zbatohet vetëm pas ndryshimit të Marrëveshjes PPP nga ana e palëve përkatëse, për shkak se çdo ndryshim i tarifave dhe/ose përjashtim i këtyre shërbimeve nga tarifat e rregulluara, kërkon ndryshimin e Marrëveshjes PPP, e cila do të miratohet vetëm nga KPPP”**, çka nënkupton se pretendimi për mos përmbushjen të detyrave të punës nga ankuesja është i paqëndrueshëm, sepse ky është problem ligjor.

Në bazë të provave të lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se nuk kemi asnjë afat kohor të dhënë nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt se cilat detyra duhet ti kryej ankuesja, e që pretendohet se nuk i ka kryer, po ashtu ankuesja në punën e saj ka përmbushur detyrat e saj të punës dhe nuk është dhënë asnjë dëshmi nga iniciuesi i procedurës disiplinore respektivisht Komisioni Disiplinor nuk ka evidentuar asnjë provë për mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjell pasoja të rënda respektivisht moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuseses “largim nga shërbimit civil”, nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, nuk ka bërë administrimin e saktë të provave që kanë të bëjnë me rastin konkret, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 45, 46, 47 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyratet Publikë, 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2, nenin 12 paragrafin 2 dhe 3 nën paragrafin 3.1 dhe 3.2, nenin 13 paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrarëve Publik sepse përveç që nuk ka konstatuar saktë shkeljen e supozuar nga ankuesja ka dështuar të shqiptoj masën disiplinore. Po ashtu Vendimi me numër V.Nr.KD/05/2020 i datës 26.11.2020 i Komisionit Disiplinor të Aviacionit Civil të Kosovës është në kundërshtim edhe me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht nenin 48 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.3 dhe 1.5 i cili përcakton se: **“Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve”**, meqenëse Vendimi me numër V.Nr.KD/05/2020 i datës 26.11.2020 i Komisionit Disiplinor të Aviacionit Civil të Kosovës është i paqartë dhe kundërthënës është në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **“Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”**, kështu që pretendimet e ankuseses janë të bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, është i obliguar që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesen [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] në Drejtoreshë e Departamentit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e saj e punës dhe duke bërë kompensimin e pagës së ankuseses nga data e pezullimit të marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: **“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”**, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është

përcaktuar se: *“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”.*

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.378/2020; datë 24.12.2020

Avdyll BEKTESHI

Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesve të ankueses, Avokat Ahmet Kasumi, Arianit Koci dhe Granit Vokshi;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.